

V E N D I M
Nr.335, datë 2.6.1998

**PËR PROCEDURAT PËR ZBATIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE PËR
DETYRIMET QË PREKIN BUXHETIN E SHTETIT**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore ndjekin zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet e institucioneve buxhetore të vartësisë së tyre. Detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore përballohen nga vetë institucioni brenda fondeve të miratuara për vitin buxhetor, sipas kriterëve e procedurave që do të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.

2. Ministria e Financave me fondin që i vihet në dispozicion në buxhetin e çdo viti, zbaton vendimet gjyqësore që lidhen drejtpërdrejtë me detyrimet e Buxhetit të Shtetit dhe jo me detyrimet e institucioneve buxhetore. Në këto vendime përfshihen:

a) Vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë me kthimin e vlerës për truallin e blerë nga qytetarët, por që në zbatim të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, i rikthehen shtetit.

b) Vendimet gjyqësore për kthimin ish-pronarëve të objekteve të privatizuara mbas shtetëzimit, si dhe të gjitha detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga ky veprim.

c) Vendimet gjyqësore që lidhen me kompensimin për burgimin ose dënimin e padrejtë.

d) Vendimet gjyqësore që lidhen me sekuestrimin e sendeve personale.

e) Vendimet gjyqësore që përcaktojnë shprehimisht detyrim të shtetit për shkaqe të tjera të parashikuara në ligje.

f) Vendimet e gjykatave ose arbitrazheve të huaja që përmbajnë detyrime për Buxhetin e Shtetit.

3. Ngarkohen Instituti i Integritit të të Përndjekurve dhe Ministria e Financave, që brenda 6-mujorit të parë të vitit 1998, t'i paraqesin Këshillit të Ministrave projektin përkatës për kompensimin e pasurive të luajtshme të ish-të përndjekurve politikë.

4. Për vendimet gjyqësore që lidhen me nenin 6 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, ngarkohet Ministria e Financave që brenda 3-mujorit të tretë të vitit 1998 të përgatisë dhe të propozojë ndryshimet përkatëse të ligjit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano